

AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË "DGC" SHPK

Sot më datë 28/02/2024 palët e mëposhtme:

- **Z. Donald Veshaj**, me numër ID J50901122N i datëlindjes 01/09/1995 lindur në Vlorë, dhe banues në Tiranë.
- **Z. Glenis Çobo**, me numër ID J10702099P i datëlindjes 02/07/1991, lindur në Vlorë, dhe banues në Tiranë.

Shprehin vullnetin e tyre për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "DGC" shpk si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria "DGC" sh.p.k, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht SHPK.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortakët

- **Z. Donald Veshaj**, me numër ID J50901122N i datëlindjes 01/09/1995 lindur në Vlorë, dhe banues në Tiranë.
- **Z. Glenis Çobo**, me numër ID J10702099P i datëlindjes 02/07/1991, lindur në Vlorë, dhe banues në Tiranë.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "DGC" Sh.p.k do të jetë:

Veprimtari në fushën e ndërtimit dhe investimeve në ndërtim. Projektim plane rregullues qendra banimi, studime urbanistike, ndërtime civile, ekonomike, industriale etj. Për drejtim punimesh (supervizion e kolaudim). Ndërtime rrugore, ndërtime hidroteknike, rikonstruksione godinash civile. Ndërtimin e rrjeteve inxhinierike. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma dhe ndërmarrje të tjera të cilat mund të kenë dhe qëllime të tjera aktiviteti. Gjithashtu për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së kësaj shoqërie dhe cdo veprimtari në lidhje më të dhe çdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm në mënyrë që të përmbushet qëllimi i veprimtarisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar, në fushën e ndërtimit shoqëria do të kryej ndërtime civile dhe industriale, furnizimi dhe instalimi i strukturave metalike të ndërtimit, punimeve për

suvatim, patinim dhe dekorim, rikonstrukcioni i strukturave metalike. Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen, zbatuese dhe/ose investimin, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave si: ndërtimin e ndërtesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, aeroporte dhe të gjitha veprave të tjera madhore. Ndërmjetësim për transaksione me pasuri të paluajtshme. Shit-blerje e pasurive të paluajtshme. Dhënie me qera. Vlerësim të pasurive të paluajtshme. Marketing. Të tjera dhe të ngjashme. Shitje, blerje, dhënie dhe marrje me qera të pasurive të luajtshme. Marrje punimesh për ndërtim, shitje, shkëmbim, ristrukturim, marrje dhe dhënie me qera, administrim dhe menaxhim pasurish të patundshme në përgjithësi në pronësi si publike ashtu edhe private. Krijimi, blerja, administrimi si direkt ashtu edhe indirekt, i ndërmarrjeve që veprojnë në sektorët ekonomike të tregtisë, industrisë dhe të shërbimeve të tretët në përgjithësi, përfshirë aktivitetet e ndërmjetësimit dhe me përjashtim të aktiviteteve të kreditimit. Operacione me natyrë industriale, financiare (Jo ndaj publikut) tregtare, mobiliare dhe imobiliare.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “DGC” Sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: Rruga Ibrahim Rugova, Zonë Kadastrale 8270, Nr. pasurie 3/280+1-20, Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 euro i konvertuar me kursin e bankës së Shqipërisë 1 Euro = 103.84 Lekë, ose 1,038,400 Lekë.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë "DGC" Sh.p.k është Z. Glenis Çobo, me numër ID J10702099P.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.


Përfaqësimi i shoqërisë tregtare "DGC" Sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortakët

Z. DONALD VESHAI



Z. GLENIS ÇOBO

